



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE

Referuar kërkesës për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit më datë 23.06.2026 nga Z. Tonin Prela bëjmë me dije si vijon:

Ankesa ka ardhur në Platformën e Bashkëqeverisjes në datë 5.06.2026 me ID 940057 në emër të z. Tonin Prela, me kërkesën për informacion lidhur me dosjen për kalimin e pronësisë për objektin pa titull pronësi sipas VKM 827 datë 30.9.2020.

Pas verifikimit paraprak të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, bazuar në pikën 1 të nenit 40 të ligjit nr. 107/2021 “Për Bashkëqeverisjen”, në datën 05.06.2026 është kryer delegimi i çështjes pranë DV ASHK Shkodër Pukë.

Rasti ka vijuar trajtimin dhe verifikimin e praktikës me DV ASHK Shkodër-Pukë, për nxjerrjen e dosjes për shqyrtim referuar afateve të përcaktuara sipas "Vendimit Nr. 827, datë 30.9.2020 "Për Përcaktimin e Rregullave të hollësishme për miratimin e Dokumentit të Pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim dhe Ligjit Nr. 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim, bëjmë me dije se ditën e sotme, datë 25.06.2026, DVASHK Shkodër-Pukë ka informuar se është marrë në shqyrtim praktika juaj, sipas VKM-së Nr. 827, datë 30.9.2020, në të cilën parashikohet afati 30-ditor i kërkesës për afishim drejtuar Bashkisë Shkodër. Pas përfundimit të afatit të afishimit publik dhe përcjelljes së shkresës nga Bashkia Shkodër për përfundimin e periudhës së afishimit publik, nëse rezulton se nuk ka patur ankesa apo pretendime nga pala të treta, ASHK Shkodër-Pukë do të konkludojë me vendimarrje lidhur me kërkesën tuaj. Platforma e Bashkëqeverisjes ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e rastit pranë institucionit përgjegjës, me qëllim garantimin e trajtimit të kërkesës brenda procedurave dhe afateve të përcaktuara.